



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit te Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. KPD/1180/2024
Nr.i fai/Br.str./Nr.pg.
Data/Uatum/Date: 03/12/2024

PRIŠTINA/PRISTINA-FRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitën në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë

Z. Arben Vitia, ministër
Ministria e Shëndetësisë

Kopje: Z. Ismail Dibrani, drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Ardita Blakaj, ushtrues i detyrës së drejtorit
Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan

Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti Shëndetësor në Burgje

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrat - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, 3 dhjetor 2024

HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vizitoi Qendrën Korrektuese për të Mitur (QKM) dhe Qendrën Edukuese-Korrektuese për të Mitur (QEKM) në Lipjan.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (më tej: MKP), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe në institucionet psikiatrike dhe në ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKP-ja më datën 15 maj 2024 ka vizituar QKM-në dhe QEKM-në në Lipjan, si dhe më 22 gusht 2024 ka vizituar Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan.

Qëllimi

Qëllimi i vizitave në QKM dhe në QEKM ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të mitur të privuar nga liria, të cilat u garantohen me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standarde ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria, vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të dërguara përmes raportit me rekomandime, datë 20 korrik 2022, hapja e kutive të ankesave, intervistimi i të miturve të cilët kanë telefonuar në IAP, si dhe intervistimi dhe shikimi i dosjeve të rasteve të cilat janë përcjellë nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve.

Bashkëpunimi i autoriteteve me MKP-në gjatë vizitës

1. Zyrtarët e shërbimit korrektues (më tej: ShKK) dhe zyrtarët e Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (më tej: DShB) i kanë ofruar ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipit i janë siguruar të gjitha informacionet e nevojshme dhe i janë mundësuar bisedat me të miturit e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe personelit shëndetësor. Ekipi monitorues ka pasur qasje në të gjitha pavijonet e vizituara.

2. Gjatë vizitës së realizuar më 15 maj 2024, në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan ishin të vendosur pesëdhjetë (50) të mitur, prej tyre shtatë (7) të mitur të dënuar, pesëmbëdhjetë (15) të mitur të paraburgosur, njëzet (20) të mitur me masë edukative dhe tetë (8) në Qendrën Edukuese Korrektuese. Kurse në vizitën e realizuar më 22 gusht 2024 janë evidentuar dyzet e nëntë (49) të mitur, prej tyre tetë (8) të mitur të dënuar, katërmbëdhjetë (14) të mitur të paraburgosur, pesëmbëdhjetë (15) të mitur me masë edukative dhe dy mbëdhjetë (12) në Qendrën Edukuese Korrektuese.

Informimi për të drejtat e të miturve

3. Neni 32, paragrafi 2, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale¹ përcakton: “*Me rastin e pranimit në institucionin korrektues, personi i dënuar (i mituri) njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së dënimit. Personi i dënuar i cili nuk di shkrim dhe lexim njoftohet gojarisht.*”

¹ Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 32, paragrafi 2.

4. MKP-ja gjatë vizitës është njoftuar nga të miturit se pasi janë pranuar, ata janë njoftuar për të drejtat e tyre në mënyrë verbale të kuptueshme.

Trajtimi i të miturve

5. Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe në Qendrën Edukuese Korrektuese për të Mitur, janë zhvilluar intervista individuale dhe grupore me një numër të të miturve dhe nuk kemi marrë ankesa lidhur me keqtrajtimin fizik, psikologjik apo përdorimin e tepruar të forcës nga stafi korrektues. Është vërejtur se ekzistonte një klimë pozitive e raporteve ndërmjet të miturve të të dy qendrave korrektuese dhe zyrtarëve korrektues.

6. Gjithashtu janë intervistuar edhe të miturit e paraburgosur të akomoduar në QKM dhe ekipi nuk ka marrë pohime lidhur me përdorimin e tepruar të forcës nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës gjatë arrestimit. Të miturit e paraburgosur kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korekte dhe profesionale nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe se janë respektuar të drejtat e tyre themelore.

Kushtet e akomodimit

7. Gjatë vizitës në objektin e QKM-së janë vizituar: Pavijoni O, i cili është rrinovuar komplekt, është bërë gëlqerosja, irregullimi i dritareve, që ka ndikuar në rritjen e ndriçimit natyror, është bërë rregullimi i inventarit dhe i shtretërve; Pavijoni I, i cili është gëlqerosur, është bërë pastrimi i dy dhomave dhe banjave; Pavijoni A, ku kishte filluar gëlqerosja së bashku me të miturit; ndërsa Pavijoni B ishte jashtë funksionit dhe renovimet kanë mbetur në gjysmë për shkak se firma kontraktuese ka dështuar dhe janë në procedura gjyqësore.

8. Në Pavijonin D, ku janë të vendosur të miturit e dënuar, gjatë vizitës së realizuar më 22 gusht 2024 është vërejtur se në dhoma mungojnë dollapët për vendosjen e rrobave, si dhe dyshekët ishin të vjetruar, kurse për sa u përket çarçafëve, të miturit janë furnizuar me çarçafë të rinj. MKP-ja ka marrë shqetësimë nga të miturit se gjatë stinës së verës kishte qenë shumë nxeh të nëpër dhoma.

9. Neni 19, paragrafi 2, i Udhëzimit Administrativ MD – NR. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese përcakton: “*Të dënuarit i sigurohet dollap i vogël, respektivisht ndarje e posaçme në dollap ose pjesë e posaçme e orëndisë për mbajtjen e sendeve të cilat mund t’i ketë me vete.*” Kurse në paragrafin 1 të nenit 19 të Udhëzimit Administrativ përcaktohet: “*Institucioni korrektues të burgosurit i siguron shtratin, dyshekun, jastëkun me këllëf, çarçafë dhe një (1) batanije gjatë stinës së verës, dy (2) batanije gjatë periudhës së dimrit, varësisht nga ngrohja.*”²

10. Në Qendrën Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan, dhomat ku qëndronin të miturit ishin të mëdha dhe kishin ndriçim të mjaftueshëm, ishin të pastra, posedonin TV dhe dollapë personalë. Secila dhomë posedonte tualetë të cilat ishin në gjendje të rregullt dhe kishin ujë të ngrohtë të mjaftueshëm.

11. Në Qendrën Edukuese Korrektuese ekziston Njësia B e që është e paraparë për akomodimin e femrave të mitura, mirëpo gjatë vizitës, MKP-ja nuk ka vërejtur asnjë të mitur femër në këtë njësi. Lidhur me këtë çështje kemi biseduar me drejtorin e Qendrës Korrektuese në Lipjan dhe sipas pohimeve të tij, Njësia B – banimi për femra në Qendrën

² Udhëzimi Administrativ MD – NR. 10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, nen 19, paragrafët 1 dhe 2.

Edukuese Korrektuese është funksionale, por nuk ka pasur kërkesa për pranimin e të miturave.

Ushqimi

12. Në QKM dhe në QEKM ushqimi sillet i gatshëm nga Qendra Korrektuese e Femrave, me një vendim të mëhershëm nga drejtoria qendrore. Edhe pse kuzhina në QEKM është funksionale, mirëpo në mungesë të stafit dhe pajisjeve të nevojshme për kuzhinë, shfrytëzohet vetëm për shpërndarjen e ushqimit për të mitur. Po ashtu kuzhina shfrytëzohet për trajnime të kulinarisë.

13. Gjatë intervistimit të të miturve, kemi pranuar disa ankesa për sa u përket cilësisë dhe sasisë së ushqimit, për këtë arsyet e miturit kerkuan që t'u mundësohet sjellja e pakove ushqimore nga shtëpia.

14. Në vizitën e realizuar më 22 gusht 2024, drejtoresha e Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan ka njoftuar se duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 04/2024 për Ushqimin e Personave të Dënuar, të miturve do t'u mundësohet edhe një racion i ushqimit.

15. Paragrafi 3 i nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 04/2024 për Ushqimin e Personave të Dënuar përcakton: “*Në menynë e ushqimit mund të parashihet edhe një ushqim shësë për të miturit pas racionit të darkës si: lëng frutash, fruta, jogurt, kifle apo ndonjë ushqim i ngjashëm i përshtatshëm për të miturit.*³”

16. “*Institucioni Korrektues kujdeset që ushqimi i cili u jepet të dënuarve duhet t’i përshtatet moshës, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe aq sa është e mundur kërkësave të tij fetare dhe kulturore.*⁴

Regjimi i të miturve

17. Programet dhe aktivitetet që ofrohen në Qendrën Edukuese Korrektuese për të Miturit në Lipjan (QEKM) janë: “Masat për trajtimin e varësisë nga droga”, që implementohet nga zyrtarë të institucionit, “Biseda për ndryshim”, “Top-s”, “Programi Y+ (Të rinjtë në rrezik), që implementohet sipas marrëveshjes nga ekspertët-trajnerët e organizatës SIT, program i cili kontribuon në deradikalizimin dhe risocializimin e të rinjve duke krijuar një mjedis që promovon drejtësinë gjinore dhe lufton dhunën mbi bazë gjinore, si dhe ndikon në përmirësimin e programeve ekzistuese të punës për të rinjtë.

18. Për të miturit ofrohet edhe Programi UP-SHIFT, i mbështetur nga UNICEF-i dhe i implementuar nga Ipko Foundation, në katër grupe: floktari, rrobaqepësi, printim dizajn dhe gravim në dru.

19. Në QEKM ofrohen edhe Aftësime Profesionale (trajnime) për të miturit në këta lëmenj: ndihmë e parë; ndërtimtari; teknologji informative; rrobaqepësi; instalim i ujit dhe ngrohje; elektroinstalues; si dhe gjuhë angleze.

20. Për arsimimin e të miturve në Qendrën Korrektuese për të Mitur (QKM) në Lipjan zhvillohet mësimi për nivelin e shkollimit fillor (kl. I deri V), të mesëm të ulët (kl. VI deri IX) dhe për nivelin e mesëm të lartë (kl. X deri XII). Në bazë të një marrëveshjeje të arritur mes Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Drejtorisë së ShML-së në Lipjan, është bërë

³ Udhëzim Administrativ MD – NR. 04/2024 për Ushqimin e Personave të Dënuar.

⁴ Po aty.

e mundur që një nxënës të dërgohet në ShFMU “Adem Gllavica” në Lipjan. Po ashtu, edhe një i mitur i dënuar vijon shkollimin universitar në vitin e dytë në drejtimin *Shkenca politike e diplomaci*. MKP-ja u njoftua se 5 të mitur nga të akomoduarit në QEKL vijojnë mësimin në shkollën e mesme në Qendrën Korrektuese për të Mitur.

21. Bazuar në nenin 2, paragrafi 3, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2017 Planifikimi dhe Organizimi i Procesit Arsimor në Arsmin Parauniversitar për Personat e Privuar nga Liria në Institucionet Korrektuese, potencohet: “*Procesi mësimor në institucionet korrektuese organizohet sipas niveleve konform legjislacionit përkatës në fuqi.*”⁵

22. Lidhur me këtë, nen 87 i Kodit Nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur përcakton: “*Çdo i mitur i moshës së detyrueshme për shkollim ka të drejtë për arsim të përshtatshëm për nevojat dhe aftësitë dhe të përcaktuara për përgatitjen e tij apo të saj për kthim në shoqëri. Kurdo që është e mundur, arsimi i tillë duhet të sigurohet jashtë objekteve të privimit nga liria, në shkollat e komunës dhe në çdo rast me arsimtarë të kualifikuar përmes programeve të integruara në sistemin arsimor, ashtu që pas lirimit, të miturit të munden që pa pengesë të vazhdojnë arsimin e tyre.*”⁶

23. Të miturit e dënuar realizojnë aktivitete sportive sipas rutinës ditore dhe organizime të turnirëve në ping-pong, futbol, volejboll, kros etj.

24. Gjatë vizitës në QKM, MKP-ja pranoi shqetësim nga të paraburgosurit me pretendimin se shumicën e kohës e kalojnë mbyllur pa marr pjesë në aktivitete, përpos shëtitjeve ditore.

25. Neni 86, paragrafi 2, i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton: “*Të miturit i garantohet një ambient i sigurtë për t'u marrë me sport, për të ushtruar dhe për aktivitete të tjera fizike.*”⁷

26. Për sa i përket regjimit në Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan, të miturit lëvizin lirshëm në hapësirat e objektit, janë të lejuar të kenë qasje në ambientet e jashtme për ajrim apo aktivitete sportive sipas orarit të përcaktuar nga drejtori i QEKL-së. Aktivitetet e përditshme në ambientet e brendshme dhe të jashtme janë të rregulluara me nenin 19 të Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së. Sipas rutinës ditore, mbyllja dhe numërimi bëhet në orën 19:00 me qëllim që në pavijone të ketë qetësi. Mbyllja dhe fikja e drithave bëhet rrëth orës 22:00, gjatë natës prapë bëhet numërimi zyrtar i të miturve, fikja e TV-ve në orën 23:00, ndërsa gjatë vikendeve në orën 24:00.

27. Gjatë vizitës në QEKL, ekipi i MKP-së ka vizituari kabinetin e Informatikës, që është i pajisur me kompjuterë; bibliotekën; kabinetin e shtypshkronjës, që posedon makineri adekuate për shtypjen e dizajnjëve në bluza, në gota; salla e rrobaqepësisë dhe e floktarisë, të cilat po ashtu janë të pajisura me mjete adekuate të punës. Të gjitha makineritë, pajisjet janë donacione nga donatorë të ndryshëm, si: Organizata Gjermane HELP, UNICEF etj. QEKL-ja posedon edhe sallën e sportit, që është shumë moderne dhe e kompletuar, si dhe sallën e fitnesit, e cila po ashtu është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme.

28. Shumica e të miturve në QEKL dhe në QKM janë të angazhuar në punë me pagesë. Mirëpo sfidë mbetet pamundësia e të miturve me Masë Edukativë që të angazhohen në punë

⁵Udhëzim Administrativ (MASHT) Nr. 15/2017 Planifikimi dhe Organizimi i Procesit Arsimor në Arsmin Parauniversitar për Personat e Privuar nga Liria në Institucionet Korrektuese, nen 2, paragrafi 3.

⁶Kodi Nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, nen 87.

⁷Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, nen 86, paragrafi 2.

jashtë institucionit edukativo-korrektues. Gjatë vizitës së realizuar më 15 maj 2024, jemi njoftuar nga drejtori i Qendrës se nuk ka pasur kërkesa të tilla dhe në momentin që do të ketë kërkesa për punësimin e të miturve jashtë institucioneve edukativo-korrektuese, do t'u përgjigjen kërkesave.

Kujdesi shëndetësor

29. I mituri, menjëherë pas pranimit në QKM dhe në QEKL, i nënshtronhet kontrollit nga personeli mjekësor brenda 24 orëve dhe për të hapet dosja mjekësore.⁸

30. Në njësinë shëndetësore në QEKL janë të angazhuar një mjeke e rregullt, një psikiatre, një psikologe, tre infermierë, kryeinfermierja dhe stomatologu. Shërbimet e tjera mjekësore, të cilat nuk mund të ofrohen në QKM, ofrohen në institucionet e tjera publike shëndetësore.

31. Kurse në njësinë shëndetësore në QEKL janë të angazhuar një mjeke e përgjithshme e rregullt, kryeinfermieri, një radiologe konsultuese, një psikiatre e rregullt dhe psikologu që ofron shërbime një herë në javë.

32. Bazuar në intervistat e realizuara me të miturit dhe me personelin shëndetësor, për sa i përket konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore, jepen nën kushte të cilat respektojnë këtë parim, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përvèç në rastet kur prania e tyre kërcohët nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

33. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, në raportin e ngjarjeve dhe incidenteve në QKM, nga janari e deri në muajin gusht të këtij viti, janë të evidentuara gjithsej 37 lëndime trupore, 9 vetëlëndime, 1 tentim vetëvrasje.

34. Sipas informatave që i kemi marrë gjatë vizitës në QKM, është shqetësuese kujdestaria e një infermieri për tri Qendrat Korrektuese në Lipjan.

35. Mirëpo shqetësime kemi pranuar edhe nga stafi korrektuese dhe nga ai shëndetësor se janë duke u përballur me një numër të madh të të burgosurve të mitur me probleme mendore dhe për trajtimin e tyre brenda Qendrës Edukuese Korrektuese mungon një vend adekuat për trajtimin e tyre.

36. Siç është e ditur në Qendrën Korrektuese në Dubravë, është themeluar Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta (IShTPNV), ku vendosen personat (të burgosurit) e të gjitha Qendrave Korrektuese dhe të Paraburgimit, të cilët kanë indikacione ekskluzive shëndetësore për trajtim në atë institucion, sipas specifikave të shërbimeve që kryhen në atë institucion. Mirëpo në IShTPNV nuk është paraparë asnjë pjesë e veçantë ku mund të trajtohen të mituri dhe femrat.

37. Andaj Avokati i Popullit, pavarësisht se e vlerëson lart themelimin e këtij institucioni, i cili ndihmon dhe trajton të burgosurit me nevoja të veçanta, vlerëson dhe rekomandon se edhe personat e mitur të burgosur me probleme të shëndetit mendor dhe vështirë të menaxhueshëm të trajtohen në një institucion të veçantë sipas specifikave të të miturve dhe interesit më të mirë të fëmijëve.

⁸ Praktika Standarde e Veprimit, dokument i DShB-së, Procedurat për pranim për herë të parë në burg-vizita e parë mjekësore.

Kontakti me botën e jashtme

38. Kontaktet me botën e jashtme, kryesisht ruajtja e lidhjeve me familjen dhe komunitetin ndihmon në procesin e rehabilitimit social të të miturve të burgosur.

39. Neni 36, paragrafi 1, i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të Qendrës Edukuese Korrektuese në Lipjan përcakton: “*Të miturit kanë të drejtë të vizitohen së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija dhe nga të që afërmit e tjerë të gjakut në vijën e drejtpërdrejtë ose në vijën anësore deri në shkallën e katërt.*”⁹

40. Të miturit gjëzojnë të drejtën edhe për telefonata, në pajtim me kohën e caktuar për kohëzgjatje të bisedës sipas Rutinës Ditore dhe kategorizimit. Kurse të miturit që nuk realizojnë vizita familjare, kanë të drejtë ta shfrytëzojnë SKYPE-in.

41. E drejta për thirrje telefonike dhe komunikim elektronik për të dënuarit është e përcaktuar edhe me LESP-në.

Masat disiplinore

42. Bazuar në Rendin e Brendshëm Shtëpiak të Qendrës Edukuese Korrektuese në Lipjan, procedura disiplinore dhe masat disiplinore përfshijnë miturin shqyrtohen dhe vendosen nga Drejtori i Institucionit brenda 48 orësh bazuar në të dhënat, informacionin dhe provat e paraqitura nga stafi përkatës.

43. Më tej, në nenin 42, paragrafi 2, të Rendit të Brendshëm Shtëpiak të Qendrës Edukuese Korrektuese në Lipjan, theksohet se masat disiplinore që mund të vendosen ndaj të miturve në QEK janë: përjashtimi nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta, deri në 3 ditë; përjashtimi nga dalja në ambientet e jashtme në grup përfshirë jo më shumë se 5 ditë; përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 10 ditë.¹⁰

44. Në nenin 90, paragrafi 2, të Kodit të Drejtësisë përfshin theksohet: “*Të miturit nuk i shqiptohet veçimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor.*”¹¹ Periudha e vendosjes në njësinë e veçantë nuk mund të kalojë pesëmbëdhjetë (15) ditë. Gjatë kësaj periudhe, i mituri ka qasje në tekste mësimore dhe literaturë në gjuhën të cilën e kuption.

45. Komiteti Evropian përfshin Parandalimin e Torturës theksion: “*Të gjitha format e izolimit të të miturve janë një masë që mund të kompromentojë mirëqenien e tyre fizike dhe/ose mendore dhe, përfshirë pasojë, duhet zbatuar vetëm si hap i fundit. Sipas këndvështrimit të KPT-së, izolimi, si masë disiplinore, duhet vendosur vetëm përfshirë periudha të shkurtra dhe, në asnjë rrethanë, përfshirë gjatë sesa tri ditë. Në rastet kur të miturit i nënshtrohen kësaj mase, atyre iu duhet ofruar mbështetje sociale e edukative, si dhe kontakti i duhur njëror. Një pjesëtar i personelit të kujdesit shëndetësor duhet ta shohë të miturin menjëherë pas vendosjes në izolim dhe, më pas, sistematikisht, të Komipaktën, një herë në ditë, si dhe t'i sigurojë atij/asaj ndihmë e trajtim të menjëherëshëm mjekësor.*”¹²

46. Bazuar në raportin e ngjarjeve – incidenteve në Qendrën Korrektuese përfshin Mitur në Lipjan, është vërejtur se nga janari e deri më 31 gusht 2024, masat disiplinore që u janë

⁹ Rendi i Brendshëm Shtëpiak në Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan, nen 36, paragrafi 1.

¹⁰ Rendi i Brendshëm Shtëpiak i Qendrës Edukuese Korrektuese në Lipjan, nen 42, paragrafi 2.

¹¹ Kodi Nr. 06/L – 006 i Drejtësisë përfshin Mitur, nen 90, paragrafi 2.

¹² CPTInf-2015-1-part-alb.docx.pdf

shqiptuar të miturve, janë: qortim - 10 raste; humbje të benefacioneve dhe privilegjeve, si: ndalim sporti për një afat të caktuar kohor - 17 raste; ndalim vizite ekstra për një afat të caktuar kohor - 11 raste; ndalim i punës jashtë pavijonit për një afat të caktuar kohor - 1 rast.

Procedura e parashtrimit të ankesave

47. Personat e vendosur në qendrat korrektuese duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë në këto qendra dhe qasja tek autoriteti i duhur duhet t'u mundësohet në mënyrë konfidenciale.

48. Neni 47 i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEK precizon: “*I mituri ka të drejtë të paraqesë një ankesë apo të ndihmohet nga menaxheri i rastit apo çdo zyrtar tjetër i Qendrës Edukuese-Korrektuese në Lipjan për të paraqitur një ankesë në lidhje me çdo lëndim apo dëmtim i pësuar si rezultat i sjelljes së të miturve të tjerë apo i një zyrtari të Qendrës Edukuese Korrektuese.*”¹³

49. Në dispozicion të të miturve në Qendrën Edukative Korrektuese dhe në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan janë të vendosura kutitë e ankesave, nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucionit dhe për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. Të miturit mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë, postës së rregullt, e cila, sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre. MKP-ja pranon ankesa nga të miturit edhe gjatë realizimit të vizitave në këto qendra.

50. Ekipi i MKP-së nuk ka marrë ankesa nga të miturit lidhur me të këtë të drejtë të garantuar me ligjet në fuqi dhe me standartet ndërkombëtare.

Konstatimet e MKP-së gjatë vizitës

51. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP), nga të gjeturat e vizitës në QKM, konstaton se në Pavijonin D mungojnë dollapët për vendosjen e rrobave dhe dyshekët janë të vjetruar. Mungesa e dyshekëve cilësorë ndikon në shëndetin fizik të të miturve, kurse mungesa e dollapëve në pastërtinë në përgjithësi.

52. MKP-ja nga të gjeturat konstaton se temperaturat e larta gjatë verës nëpër dhomat e të miturve ndikojnë në shëndetin fizik dhe mendor të të miturve, duke shkaktuar dehidrim dhe lodhje.

53. MKP-ja konstaton se ushqimi jocilësor dhe i pamjaftueshëm për të miturit ndikon në dobësimin e sistemit imunitar dhe rrithjen e rrezikut për sëmundje.

54. MKP-ja konstaton se mungesa e aktiviteteve te të miturit e paraburgosur ndikon në moszhvillimin e raporteve sociale për komunikim dhe bashkëpunim me të tjerët.

55. MKP-ja konstaton se kujdestaria e një infermieri për tri qendrat korrektuese në Lipjan nuk mund të ofrojë kujdes të mjaftueshëm.

¹³ Rendi i Brendshëm Shtëpiak i Qendrës Edukuese Korrektuese në Lipjan, nen 47, paragrafi 1.

56. MKP-ja konstaton se mungesa e një institucioni ku mund të trajtohen të miturit e burgosur me probleme të shëndetit mendor dhe vështirë të menaxhueshëm, mund të ndikojë në përkeqësimin e shëndetit mendor të të miturve, po ashtu mungesa e këtyre institucioneve të specializuara mund të përbëjë shkelje të këtyre të drejtave, duke i lënë ata të pafavorizuar në krahasim me të rriturit.

57. Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKP-së gjatë vizitës në QEKL dhe në QKM, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- *Të miturit të furnizohen me dyshekë cilësorë dhe me dollapë për vendosjen e rrobave.*
- *Të ndërmerren masa që në dhomat ku mbretërojnë temperaturat e larta të pajisen me kondicionierë.*
- *Të miturve t'u sigurohet ushqim cilësor dhe i mjaftueshëm.*
- *Të bëhen përpjekje që të miturit e paraburgosur të angazhohen më tepër në aktivitete.*
- *Të themelohet një institucion ku ofrohet kujdes i veçantë për të miturit e burgosur me probleme të shëndetit mendor duke u mundësuar të miturve trajtim të duhur.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj.*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekandimit, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

